



REPUBLIKA E SHQIPËRISË KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

PËR DHËNIE AUTORIZIMI PËR NDRYSHIMIN E VENDNDODHJEVE TË DISA QV-VE, PËR ZGJEDHJET PËR ORGNET E QEVERISJES VENDORE, TË DATËS 30 QERSHOR 2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 26.06.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI -	Anëtar
Edlira	JORGAQI -	Anëtare
Rezarta	BITRI -	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjeve të disa qendrave të votimit, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 62, pika 4, neni 93, pika 2, gërma "a", të Ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoji diskutimet e të pranishmëve,

V E R E N

Kzaz nr.28, Bashkia Kamëz (NJ.A.Paskuqan), në përmbushje të detyrës, ka kryer verifikimin e ambienteve të qendrave të votimit nga ku konstatuarse pronarët e disa ambienteve private në të cilat janë caktuar disa QV nuk pranojnë vënien në dispozicion të tyre. Për këtë. KZAZ nr. 28, me shkresën nr.12180 prot., datë 24.06.2019, i është drejtuar KQZ, duke propozuar ndryshimin e vendndodhjeve të:

- QV nr.2049, 2049/1, 2049/2 të caktuara në lokal privat Asllan Qefalia, propozohet të caktohen në lokal privat Tahir Sinani.
- QV nr.2049/3 e caktuar në lokal privat Zihni Plaku, propozohet të caktohet në Shkollën "Tahir Sinani".
- QV nr.2040/2 e caktuar në lokal privat "Puci", propozohet të caktohet në Shkollën "Jashar Hoxha".



Kzaz nr.46, Bashkia Cërrrik, në përmbushje të detyrës, ka kryer verifikimin e ambienteve të qendrave të votimit nga ku konstatuarse pronarët e disa ambienteve private në të cilat janë caktuar disa QV nuk pranojnë vënien në dispozicion të tyre. Për këtë. KZAZ nr. 46, me shkresën nr.12333 prot., datë 26.06.2019, i është drejtuar KQZ, duke propozuar ndryshimin e vendndodhjeve të:

- QV nr.2508, propozohet të caktohet në shkollën "A. Buda".
- QV nr.2511, 2512 propozohet të caktohet në Shkollën bujqesore.
- QV nr.2517, propozohet të caktohet në objekt privat "Rruzhdhi Lici".
- QV nr.2521, propozohet të caktohet në objekt privat "Qamil Muça".
- QV nr.2531, 2531/1 propozohet të caktohet në objekt privat "Agron Kuqja".
- QV nr.2534, propozohet të caktohet në objekt privat "Idajet Baku".

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1, gërma "a", nenin 62, pika 4, neni 93, pika 2, gërma "a", të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

V E N D O S I :

1. Dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjeve të QV-ve sipas lidhjes 1 bashkëlidhur këtij vendimi.
2. KZAZ nr.28 dhe KZAZ nr.46 të publikojnë menjëherë listat e zgjedhësve në vendndodhjet e qendrave të votimit, caktuar me këtë vendim.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda pesë ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare

